

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Franca pas vendimit të Hagës: Mbështetja për pavarësinë e Kosovës është e palëkundur - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/franca-pas-vendimit-te-hages-mbeshtetja-per-pavaresine-e-kosoves-eshte-e-palekundur/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:43:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:20:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8d096076ac26d22a992f1573290409c2e0b35b39c1c481d107b8a3d91e9e7037
TEKSTI	71c247e3b47d8b8203a8c1048db418d34fc9eefda218d531ed68dde92817c8bd
PAMJA	f7e8233e3477c8d7b9bb27aff9b29f2c491a43c3f143e08f71c42417a107631d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	557d5220fbb6f535b4a0bb5e0a7de9059f33faf8533d5d5ce4fc128ec95f2474
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efaeb014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/557d5220fbb6f535b4a0bb5e0a7de9059f33faf8533d5d5ce4fc128ec95f2474>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: [Home](#) » [Franca pas vendimit të Hagës: Mbështetja për pavarësinë e Kosovës është e palëkundur](#)

KOSOVË

Demo

Franca pas vendimit të Hagës: Mbështetja për pavarësinë e Kosovës është e palëkundur

SEPTEMBER 16, 2026



Franca ka rikonfirmuar mbështetjen e saj për pavarësinë e Kosovës dhe institucionet e saj, pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Ministria franceze për Evropën dhe Punët e Jashtme deklaroi se ka marrë në dijeni vendimin në çështjen "Thaçi dhe të tjerët", duke theksuar se aktgjykimi është i apelueshëm dhe se palët kanë të drejtë të ndjekin procedurat e ankimit.

"Ky vendim, i cili mund të apelohej, shënon përfundimin e proceseve të shkallës së parë para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve që lidhen me pengimin e administrimit të drejtësisë", thuhet në deklaratën e publikuar në faqen zyrtare të ministrisë franceze.

Parisi zyrtar ka përsëritur gjithashtu mbështetjen për Dhomat e Specializuara të Kosovës, duke nënvizuar angazhimin e Francës në luftën kundër pandëshkueshmërisë.

"Franca përsërit mbështetjen e saj për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe rikujton angazhimin në luftën kundër pandëshkueshmërisë. Ajo gjithashtu rikonfirmon mbështetjen e palëkundur për pavarësinë e Kosovës dhe institucionet e saj", thuhet më tej në deklaratë.

Reagimi i Francës vjen pas shpalljes fajtorë të katër ish-krerëve të UÇK-së nga trupi gjyqësor, për krime lufte që lidhen me arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme.

Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.

Aktgjykimi është i shkallës së parë dhe nuk është i formës së prerë. Mbrojtja e të dënuarve ka bërë të ditur se do ta ankimojë vendimin në Dhomën e Apelit.

franca

SHARE.

Postimet e reja

Meidani pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së: N...

SEPTEMBER 16, 2026

Franca pas vendimit të Hagës: Mbështetja për...

SEPTEMBER 16, 2026

Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, PDK kërkon...

SEPTEMBER 16, 2026

Marta Kos pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së:...

SEPTEMBER 16, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu